



REPUBLIKA E KOSOVËS-REPUBLIKA KOSOVA-REPUBLIC OF KOSOVO
KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBE KOSOVA
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD CIVIL SERVICE OF KOSOVO



Pranuar / Dorezuar Prijmljeno/Prodato Received/Delivery	17. 11. 2022	2	viti god year
Organ /Njësia Organ /Jedinica Org /Unit	Nr Prot Br Prot Prot No	Shtojca Prilog Appendix	Saeta Kolicina Quantity
SKMMSHICK	7202/2022		014



Republika e Kosovës Republika Kosova - Republic of Kosovo

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBE KOSOVA
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD FOR THE CIVIL SERVICE OF KOSOVO

A.nr.858/2022

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës - Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave në përbërje nga: Jeton Koca-kryetar, Ardita Haxhnikaj - Demi dhe Malsore Gashi - Bajraktari, anëtare me Zyle Millaku Gojnovci - Zyrtare e Lartë për Bashkëpunim Profesional, në cilësi të procesmbajtëses, ka shqyrtuar ankesën me numër A.nr.858/2022 të datës 04.10.2022 të parashtruar nga Dashurije Gashi, përmes përfaqësueses së autorizuar [redacted] me adresë:

kundër organit të punësimit/Komuna e Dragashit, në çështjen juridike "kompensim material", duke vepruar në pajtim me nenin 6 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1 dhe nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës dhe Rregulloren Nr.02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, në seancën për këshillim dhe votim të mbajtur më datën 17.11.2022, mori këtë:

V E N D I M

I. Refuzohet si e pa bazuar ankesa me numër A.nr.858/2022 e datës 04.10.2022 e parashtruar nga ankuesja [redacted]

II. Mbetet në fuqi Vendimi i datës 15.09.2022, i Udhëheqësit të Personelit të Komunës së Dragashit.

A r s y e t i m

Ankuesja [redacted] të cilën me autorizim e përfaqëson [redacted] me datë 04.10.2022 ka parashtruar ankesë me numër protokollit 5875 të regjistruar nën shenjen A.nr.858/2022 në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, kundër Vendimit të datës 15.09.2022 të Udhëheqësit të Personelit të Komunës së Dragashit, me të cilin akt administrativ i është refuzuar kërkesa për kompensimin edhe të dy pagave përcjellëse me rastin e pensionimit dhe katër pagave jubilarë, sipas Kontratës së Përgjithshme Kolektive të Kosovës.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, bazuar në dispozitat e Rregullores Nr.02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave, me datë 07.10.2022 ka dërguar kërkesën për përgjigje në ankesë te Komuna e Dragashit, ndërsa me datë 14.10.2022 ka pranuar përgjigje në ankesë se bashku me shkresat e bashkangjitura të lëndës, 1/5 faqe.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave, administroi këto prova: Ankesën me numër protokoll 5875 të regjistruar nën shenjen A.nr.858/2022 në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës; Vendimin e datës 01.12.2021 të Kryetarit të Komunës së Dragashit; Listën e pagave të muajit tetor 2018; Vendimin me numër protokoll 120/08-6631/22 të datës 15.09.2022 të Udhëheqësit të Burimeve Njerëzore; Kërkesën e datës 05.04.2022 drejtuar Njësisë së Personelit; Vendimin e datës 03.12.2021; Vendimin e datës 06.12.2021 të Udhëheqësit të Burimeve Njerëzore; Vendimin e datës 03.12.2021 të Kryetarit të Komunës; Librezë e punës Nr.3617/75; Autorizimin e datës 26.09.2022; Përgjigjen në ankesë të datës 14.10.2022; Lista e pagës të muajit dhjetor 2021; Emailin e datës 15.11.2022 me provë shtesë, bashkangjitur Akt emërimit e ankueses të datës 01.02.2012.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave, pasi ka shqyrtuar të gjitha shkresat e bashkangjitura të lëndës të dërguara nga ankuesi dhe organi i punësimit, ka konstatuar se ankesa e ankueses, *është e pa bazuar, sepse:*

Nga administrimi i shkresave të lëndës është konstatuar se ankuesja sipas Akt Emërimit të datës 01.01.2012, ka qenë e punësuar në pozitën *Receptioniste* pranë Komunës së Dragashit.

Të njëjtës në bazë të Vendimit të datës 01.12.2021 të Kryetarit të Komunës së Dragashit, i është përfunduar marrëdhënia e punës me datë 02.12.2021 për shkak të arritjes së moshës së pensionimit, ndërsa me vendimin pasues të datës 03.12.2021, ankueses i është njohur e drejta e kompensimit të një pagese të njëhershme në vlerën e pagës së fundit, në shumën prej 360.91 euro.

Ankuesja, më datë 05.04.2022 ka parashtruar kërkesë të Udhëheqësi i Personelit dhe Komisioni për Zgjidhjen e Kontesteve dhe Ankesave pranë Komunës së Dragashit, për kompensimin edhe të dy pagave në emër të pagave përcjellëse me rastin e pensionimit dhe katër pagave jubilarë në emër të shpërblimit për përvojë pune, sipas Marrëveshjes së Përgjithshme Kolektive të Kosovës.

Udhëheqësi i Personelit i Komunës së Dragashit, me Vendimin e datës 15.09.2022 ka refuzuar kërkesën e ankueses të datës 05.04.2022, me arsyetimin se kompensimi me rastin e pensionimit të ankueses është bërë në pajtim me dispozitat e Ligjit Nr.03/L-147 për Pagat e Nëpunësve Civil dhe Rregulloren Nr.33/2012 për Shtesat në Pagë dhe Kompensimet e Tjera të Nëpunësve Civil, me c' rast e njëjta në emër të pagës përcjellës, në muajin dhjetor 2021 ka realizuar një pagë të njëhershme në vlerë prej 360.91 euro, ndërsa në emër të shpërblimit jubilar për dhjet vjet përvojë pune në Shërbimin Civil, në muajin tetor 2018 ka realizuar 25% të pagës mesatare në Shërbimin Civil, apo 99.00 euro.

Ankuesja në ankesën e parashtruar në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, nuk e konteston kompensimin e realizuar sipas dispozitave të Rregullores Nr.33/2012 për Shtesat në Pagë dhe Kompensimet e Tjera të Nëpunësve Civil, gjegjësisht

shumen e mjeteve prej 360.91 të realizuara në emër të pagës përcjellëse me rastin e pensionimit, apo shumen prej 99.00 euro të realizuar në emër të shpërblimit jubilar, mirëpo e njëjta pretendon që t'i njihet e drejta e kompensimit edhe e dy pagave përcjellëse me rastin e pensionimit, dhe katër pagave jubilarë mbi bazën e Kontratës së Përgjithshme Kolektive të Kosovës.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave, lidhur me shqyrtimin e pretendimeve ankimore të ankueses ka analizuar bazën ligjore mbi të cilën janë ngritur pretendimet ankimore të ankueses dhe ka konstatuar se Marrëveshja e Përgjithshme Kolektive e Kosovës, e publikuar në Gazetën Zyrtare Nr.38/2014 të datës 18.06.2014, ka hyrë në fuqi me datë 01.01.2015 dhe e njëjta sipas nenit 90 paragrafi 4 të Ligjit Nr.03/L-212 të Punës, ka qenë e zbatueshme në periudhë jo me shumë se tri (3) vjet, respektivisht deri me datë 31.12.2017. Rrjedhimisht, Oda Ekonomike e Kosovës si Partner i barabartë në Këshillin Ekonomiko Social, dhe njeherit nënshkruese e Marrëveshjes së Përgjithshme Kolektive të Kosovës, me datë 15.09.2017 është tërhequr nga zbatimi i Marrëveshjes së Përgjithshme Kolektive të Kosovës, dhe kjo tërheqje ka pamundësuar zbatimin e kësaj marrëveshje, pas datës 31.12.2017.

Andaj, duke marr parasysh se ankuesja ka arritur moshën e pensionimit me datë 02.12.2021, në kohën kur nuk ka qenë në fuqi Marrëveshja e Përgjithshme Kolektive e Kosovës, Kolegji i Këshillit konstaton se pretendimi ankimor i ankueses për realizimin edhe të dy pagave përcjellëse me rastin e pensionimit mbi bazën e dispozitave të Marrëveshjes së Përgjithshme Kolektive të Kosovës, e publikuar në Gazetën Zyrtare Nr.38/2014 të datës 18.06.2014, është i pa bazuar.

Për me tepër, nga administrimi i shkresave të lëndës, gjegjësisht lista e pagave të muajit dhjetor 2021 është konstatuar se ankuesja me rastin e arritjes së moshës së pensionimit ka realizuar një pagë përcjellëse, gjegjësisht një pagesë të njëhershme në vlerë prej 360.91 euro, kompensim ky në përputhje me dispozitat e nenit 22 paragrafi 2 nën paragrafi 2.2 dhe paragrafi 3 të Ligjit Nr.03/L-147 për Pagat e Nëpunësve Civil, dhe dispozitat e Rregullores Nr.33/2012 për Shtesat në Pagë dhe Kompensimet e Tjera të Nëpunësve Civil, përkatësisht nenin 19 paragrafi 2 ku përcaktohet se: *Nëpunësi civil, që arrin moshën e pensionimit, gëzon të drejtën e marrjes së një pagese në shumën prej një (1) page mujore të njëhershme në vlerën e pagës së fundit.*

Po ashtu, duke marr parasysh tani më konstatimin e dhënë se Marrëveshja e Përgjithshme Kolektive e Kosovës nuk ka qenë në fuqi pas datës 31.12.2017, dhe meqenëse edhe pretendimi ankimor i ankueses për realizimin e katër pagave jubilarë mbështetet në bazë të njëjtë juridike, gjegjësisht Marrëveshjen e Përgjithshme Kolektive të Kosovës, Kolegji i Këshillit konstaton se ky pretendim ankimor është i pa bazuar sepse nga shkresat e lëndës është konstatuar se ankuesja kushtin për realizimin e shpërblimit jubilar lidhur me përvojën e punës në Shërbimin Civil, e ka plotësuar në vitin 2018, periudhë kjo kur ky akt juridik nuk ka qenë në fuqi dhe si i tillë nuk ka mundur të prodhoj pasojë juridike.

Ndërsa nga administrimi i shkresave të lëndës është konstatuar se ankuesja me listën e pagave të muajit tetor 2018 ka realizuar 25% të pagës mesatare në Shërbimin Civil, apo 99.00 euro, në emër të shpërblimit jubilar për dhjetë vjetorin e fundit të përvojës së punës, kompensim ky i realizuar në përputhje me dispozitat e Rregullores Nr.33/2012 për Shtesat në Pagë dhe Kompensimet e Tjera të Nëpunësve Civil, përkatësisht nenin 21 ku përcaktohet

se: Sipas Nenit 22 të Ligjit për Pagat e Nëpunësve Civilë, nëpunësve civilë, të cilët janë në marrëdhënie të vazhdueshme pune në Shërbimin Civil iu takon një shpërblim në vlerë prej 25% të pagës mesatare në Shërbimin Civil pas çdo dhjetë (10) vjetësh pune.

Për sa me sipër, Kolegji i Këshillit konstaton se organi i punësimit gjegjësisht Komuna e Dragashit me rastin e realizimit të një page përcjellëse me rastin e pensionimit, gjegjësisht një pagesë të njëhershme në vlerë e pagës së fundit, apo 360.91 euro, si dhe kompensimi i një shpërblimi në vlerën prej 25% të pagës mesatare në Shërbimin Civil, apo 99.00 euro, në emër të shpërblimit jubilar për dhjetë vjetorin e fundit të përvojës së punës, për ankuesin, ka zbatuar drejte ligjin material duke vepruar kështu në pajtim me dispozitat e Ligjit Nr.03/L-147 për Pagat e Nëpunësve Civil, dhe Rregulloren Nr.33/2012 për Shtesat në Pagë dhe Kompensimet e Tjera të Nëpunësve Civil, ndërsa pretendimet ankimore të ankueses mbi bazën e dispozitave të Marrëveshjes së Përgjithshme Kolektive të Kosovës nuk qëndrojnë dhe si të tilla janë të pa bazuara, sepse Marrëveshja e Përgjithshme Kolektive e Kosovës nuk ka qenë në fuqi në kohën kur ankuesja pretendon se i kanë lindur të drejtat nga marrëdhënia e punës.

Kështu që pas analizimit dhe vlerësimit të të gjitha shkresave të lëndës si dhe duke u bazuar nënin 18 paragrafi 1 nën paragrafi 1.1 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, si dhe neni 132 paragrafi 2 të Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, Kolegji i Këshillit vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit nga Kryetari i Kolegjit.

Këshillë juridike: Kundër vendimit të Këshillit, pala e pakënaqur e cila pretendon se vendimi i Këshillit nuk është i ligjshëm mund të iniciojë konflikt administrativ në Gjykatën Themelore në Prishtinë-Departamenti për Çështje Administrative, brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh nga dita në të cilën i është dorëzuar vendimi. Inicimi i konfliktit administrativ nuk e ndalon ekzekutimin e këtij vendimi

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
Lënda me numër A.nr.858/2022.

Zyle Millaku GOJNOVCI

Procesmbajtëse

Jeton KOÇA

Kryetar i Kolegjit

Vendimi i dorëzohet:

- Përfaqësuesit të autorizuar të ankueses;
- Kryetarin të Komunës së Dragashit;
- Udhëheqësit të Personelit në Komunën e Dragashit; dhe
- Arkivit të KPMSHCK-së.